

VENDIM
Nr. 269, datë 27.10.2025

MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 68, DATË 8.4.2025, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘RENEW’ SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 2 mw”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.10.2025, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme, me nr. 2532/3 prot., datë 24.10.2025, “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 68, datë 8.4.2025 “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Renew’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 mw”,

konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “Renew” sh.p.k.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 68, datë 8.4.2025, ka licencuar shoqërinë “Renew” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 mw, për një afat 30-vjeçar.

- Në kuptim të sa përcaktuar në pikat 2, 3, 4 dhe 5, shoqëria duhet të raportojë në ERE, në lidhje me fillimin e punimeve për ndërtimin e centralit brenda datës 31.8.2025; të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 30.9.2025; si dhe jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga data e fillimit të operimit, të dokumentojë në ERE testimin e veprës dhe përditësimin e informacionit mbi strukturën organizative. Ky vendim është objekt rishikimi në rast të përmbushjes apo mospërmbushjes së kushteve 2, 3 dhe 4.

2. Korrespondenca dhe dokumentacioni i depozituar nga shoqëria

- Shoqëria “Renew” sh.p.k., me shkresën e datës 20.6.2025, protokolluar në ERE me nr. 1920 prot., datë 23.6.2025, ka njoftuar fillimin e punimeve të “Ndërtimit të impiantit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 2 mw dhe veprave ndihmëse”, nga data 4.7.2025.

- Me shkresën e datës 8.10.2025, protokolluar në ERE me nr. 2532/2 prot., datë 8.10.2025, shoqëria ka depozituar procesverbalin e datës 4.7.2025, nënshkruar midis shoqërisë zhvilluese “Renew Energy” sh.p.k., subjektit ndërtues “Kirac Green Energy” sh.p.k., dhe mbikëqyrësit të punimeve “ABKONS” sh.p.k., si dhe kopjen e lejes së ndërtimit të zbardhur nr. 1100/7 prot., datë 12.6.2025, me afat 12-mujor.

3. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Referuar dokumentacionit të paraqitur (njoftimi i datës 23.6.2025 dhe procesverbali i datës 4.7.2025), rezulton se kushti i përcaktuar në pikën 2, të vendimit nr. 68, datë 8.4.2025 (raportimi i fillimit të punimeve brenda datës 31.8.2025) është përmbushur dhe për rrjedhojë, vlerësohet të shfuqizohet.

- Leja e ndërtimit nr. 1100/7, datë 12.6.2025, ka afat 12-mujor që përfundon më 11.6.2026; po ashtu, në nenin 9, pika 2 të kontratës me MIE-n nr. 2426 rep., nr. 1571 kol., datë 28.4.2023, parashikohet vënia në punë brenda 12 muajve nga marrja e lejeve për fillimin e punimeve. Në këto kushte, afati për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë së prodhimit vlerësohet të përshtatet me afatin maksimal të lejes së ndërtimit.

4. Nevoja për ndryshimin e vendimit

- Në mbështetje të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se një akt administrativ mund të ndryshohet, shfuqizohet apo anulohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë për ta nxjerrë atë, vlerësohet se pika 2 e dispozitivit të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 68, datë 8.4.2025, duhet të shfuqizohet, pasi shoqëria “Renew” sh.p.k. ka përmbushur kushtin përkatës.

- Për sa më sipër, vlerësohet të ndryshojë kushti i përcaktuar në pikën 3 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 68, datë 8.4.2025, duke ju referuar tashmë afatit kohor të lejes së ndërtimit si afati maksimal për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike nga shoqëria “Renew” sh.p.k., afat i cili llogaritet të jetë data 11.6.2026.

- Gjithashtu, me plotësimin e kushtit të përcaktuar në pikën 2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 68, datë 8.4.2025, dhe pika 5 e vendimit duhet të reflektojë këtë ndryshim dhe të përcaktojë se ky vendim është objekt rishikimi në rast të përmbushjes apo mospërmbushjes së kushteve të mbetura të këtij vendimi, konkretisht ato të përcaktuara në pikat 3 dhe 4 të tij.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 2, e vendimit të ERE-s nr. 68, datë 8.4.2025, shfuqizohet.

2. Pika 3, e vendimit të ERE-s nr. 68, datë 8.4.2025, ndryshon dhe bëhet: “Shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 11.6.2026.”.

3. Pika 5, e vendimit të ERE-s nr. 68, datë 8.4.2025, ndryshon dhe bëhet: “Ky vendim është objekt rishikimi në rast të përmbushjes apo mospërmbushjes së kushteve të përcaktuara në pikat 3 dhe 4 të këtij vendimi.”.

4. Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme të njoftojë shoqërinë “Renew” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, “OSSH” sh.a., “FTL” sh.a. dhe “ALPEX” sh.a., lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti